

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300903/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Përmet.*

**Drejtuar:** **Z. Bledar METAJ**  
Shef i Komisariatit të Policisë

**PËRMET**

**Për dijëni:** **Drejtues i parë Z. Ardian ÇIPA**  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

**GJIROKASTËR**

*Të nderuar,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisariatin e Policisë Përmet nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Përmet në datën 11.10.2023, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar; Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"; dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"., si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrorjë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Përmet z. Bledar Metaj, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, shefi i komisarariatit informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në inspektimin e mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve sipas procedurave standarde të dhomave të shoqërimit të këtij komisaritati.

Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin edhe me punonjësit e policisë së zyrës së informacionit dhe të shërbimeve të tjera.

Grupi i inspektimit në vijim inspektoi dhomat e shoqërimit, zyrat e punës të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, si dhe këqyri e kontrolloi plotësimin sipas rubrikave të regjistrit ku evidentohen të dhënat e personave të shoqëruar/të ndaluar apo të arrestuar, librin e kërkesë/ankesave, regjistrin për të miturit në konflikt me ligjin, si dhe plotësimin e modelit të formularit të shoqërimit, ruajtjen dhe administrimin e kopjeve të procesverbaleve të shoqërimit.

Theksojmë se, shefi i komisarariatit dhe punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij komisaritati.

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i datës 09.05.2022, nga informacioni dhe evidentimi në vend i kushteve ku mbahen persona të shoqëruar, të ndaluar/arrestuar, grupi i inspektimit konstatoi se<sup>1</sup>:

- ✓ Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi, për krijimin e ambienteve të përshtatshme për marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar gjatë kryerjes të veprimeve procedural. Zyra kishte karrige dhe tavolina, por mungonin kompjuter pune për specialistët e policisë, si dhe instalimi i kamerave të monitorimit të kësaj zyre<sup>2</sup>.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se disa rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varet nga njësia vendore. Çdo Komisarariat duhet të demostrojë se ka qenë konsequent në kërkimin e fondeve.

Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se:

---

<sup>1</sup> Dërguar rekomandimi për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Përmet, nr. K4/I29-2 prot, datë 08.07.2022.

<sup>2</sup> Kthim përgjigje të rekomandimit tonë me numer 719/1 prot, datë 19.08.2022

- ✚ **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për instalimin e një sistemi cilësor të monitorimit me kamera në zyrat ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar, ndaluar/arrestuar, në Komisariatin e Policisë Përmet.
- ✚ **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisariatit të Policisë Përmet, për shtetaset gra të shoqëruara, ndaluara/arrestuara në konflikt me ligjin.
- ✚ **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomave të intervistimit për të miturit në konflikt me ligjin dhe pajisjen me orëditë e nevojshme si karrige, tavolinë dhe kompjuter pune për specialistët e policisë, si dhe instalimin e kamerave të monitorimit në zyrën e posaçme për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
- ✚ **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

Avokati i Popullit është koshent se këto rekomandime kërkojnë fonde buxhetore por evidentuar se kërkesat ishin të përfshira dhe të Drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, lidhur me krijimin e kushteve sipas standardeve për krijimin e dhomave të shoqërimit dhe ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

Në përfundim të inspektimit, grupi inspektues vëren se megjithëse në Komisariatin e Policisë Përmet ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, ka ende vend për përmirësimin e disa aspekteve që do të trajtohen më poshtë:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisariatin e Policisë Përmet ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës kryesore dhe në përgjithësi ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”. Në këtë komisarjat janë krijuar dhoma shoqërimi të ndara më vete për gratë, burrat dhe të miturit<sup>3</sup>.

Dhomat e shoqërimit kishin hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme dhe ishin të pajisura me tavolina dhe me karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4m x 3m dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijojnë mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Gjithashtu kishte edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

<sup>3</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Dera ishte prej druri, me mundësi për t'u mbyllur nga jashtë. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje/ftohjeje.

Mjedisi dhe dhomat e shoqërimit ishin të mirëmbajtura, të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodhej 1 (një) tualet me ujë të rrjedhshëm 24 orë dhe i pajisur me të gjitha mjetet e domosdoshme. Në ambientet e këtij komisariati mungonte tualeti për gra, duke mos garantuar në këtë pikë standardin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit<sup>4</sup>”.

Nga inspektimi i ambienteve të shoqërimit gjendej një dhomë e veçantë për marrjen në pyetje/intervistimin e personave në konflikt me ligjin, e cila ishte e pajisur me tavolina, karrige për qëndrimin ulur të shtetasve, por mungonin orenditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë, si dhe nuk kishte kamera monitorimi të instaluar.

Ndërsa, mjediset e dhomave të shoqërimit, ambientet e brendshme dhe pjesa e jashtme e komisariatit, ishin të survejuara nga sistemi i kamerave përgjatë 24 orëve.

Në Komisaratin e Policisë Përmet, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 11.09.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **105** persona, ku saktësisht **103** shtetas madhorë dhe **3** shtetas të mitur në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Në kohën e kryerjes së inspektimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e komisariatit, për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk realizoi intervista lidhur me trajtimin që iu bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë nga momenti i shoqërimit, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit dhe marrjes në pyetje apo intervistimit të tyre.

U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Gjithashtu u informuam se karta e të drejtave të njeriut i jepet çdo personi të shoqëruar/ndaluar apo arrestuar, që në momentin e hyrjes në ambientet e komisariatit duke garantuar njohjen e të drejtave që nga fillimi i privimit të lirisë. Avokati i Popullit kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave që në momentin e hyrjes në komisariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat që ata gëzojnë. Sipas nenit 255/4 të Kodit Penal, policia informonte pa vonesë familjen e personit të ndaluar/ arrestuar, praktikë kjo e zbatuar në këtë komisariat.

Nga verifikimi i regjistrin të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2022 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar. Kërkuam shpjegime dhe na u njoftua se asnjë nga personat e shoqëruar dhe të arrestuar nuk ka paraqitur asnjë ankesë me vullnet të plotë.

---

<sup>4</sup> Kreu VII, pika 4 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, ku përcaktohet se: “Brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to, të ketë tualete, të ndara për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim”.

Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë rast, apo u administrua ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues. Gjatë inspektimit u këqyrën të gjitha zyrat e oficerëve të Policisë Gjqësore në të gjitha ambientet e komisariatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisarlatin e Policisë Përmet nuk kishte ambiente të sigurisë. Personat e arrestuar/ndaluar, pasi përfundonin veprimet procedurale, dërgoheshin nga punonjësit e policisë në dhomat e sigurisë të Komisarlatin të Policisë Gjirokastër.

### **Regjistri i personave të shoqëruar dhe trajtimi i të shoqëruarve**

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Përmet, “*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*” ishte i ri sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Personat e shoqëruar në mjediset e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit<sup>5</sup> dhe ishte i sekretuar.

Në këtë komisarlat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarlat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, por për periudhën që u krye inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Gjithashtu posterat e vendosur në institucion, pasqyronin edhe të drejtën e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar për të bërë ankesa nëse kishin të tilla.

Gjithashtu, në këtë komisarlat administrohej regjistër për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2023 kishte vetëm 3 të shoqëruar të mitur në konflikt me ligjin.

---

<sup>5</sup> Kreu VII, procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Në zyrën e informacionit, ndodhej edhe një regjistër për takimet me avokatin kur kërkohet nga të shoqëruarit, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe në disa gjuhë të huaja.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisaratin e Policisë së Përmet, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk janë të monitoruara me kamera, që do mundësonte mbajtjen në vëzhgim të oficerëve të policisë gjyqësore, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale apo kundërveprimet e paligjshme të të shoqëruarve ndaj punonjësve të policisë<sup>6</sup>.

Në Komisaratin e Policisë Përmet ishte krijuar një dhomë intervistimi, e cila ishte e pajisur me tavolina, karrige për qëndrimin ulur të shtetasve, por mungonin orënditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë, si dhe nuk kishte kamerat e monitorimit të instaluar. Kjo zyrë shërbente si zyrë pune për Specialistin e Policisë së Zonës (SPZ) dhe njëkohësisht shërbente edhe për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar vetëm nga specialisti i Policisë së Zonës (SPZ) të institucionit. Megjithatë kjo dhomë nuk i plotëson kushtet dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për krijimin e zyrës së veçantë ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë Gjyqësor dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këtë zyrë. Dhoma e intervistimit duhet të jetë e ndërtuar në zbatim të procedurës standarde të miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke u shndërruar në rregull të detyruar për punonjësit e policisë.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto **zyra, por është konstatuar se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar**<sup>7</sup>.

Avokati i Popullit, referuar standardeve kombëtare e ndërkombëtare e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Gjithashtu, Komisarati i Policisë Përmet nuk ka një hapësirë të posaçme (dhomë) për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë

---

<sup>6</sup>Kreu VII, pika 4/d e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici” përcakton se: “Në mjediset ku pyetet i shoqëruari të kenë të vendosura pajisje e orëndi pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si tavolina e karrige si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të jenië fiksuar dhe të palëvizshme”.

<sup>7</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të tillë që të shërbejë për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

Nga inspektimi që ju bë zyrave të punonjësve të policisë në këtë komisariat, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat që merren në pyetje në këto ambiente.

### **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë.

Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me Bashkinë Përmet, si dhe me shkollën e mesme të këtij qyteti. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Përmet ishte zhvilluar konform ligjit.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Spitalin Rajonal të Përmetit për të marrë ndihmë mjekësore.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Duke qenë se karta e të drejtave në këtë komisariat jepet në momentin e hyrjes të personave në komisariat, dijenia mbi të drejtat konsiderohet e mjaftueshme.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të Procedurave Standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

## **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen me orenditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë<sup>8</sup> dhe instalimin e kamerave monitoruese në dhomën e intervistimit dhe vënien e saj në funksion për marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Përmet, për shtetaset gra të shoqëruara, ndaluara/arrestuara në konflikt me ligjin.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**

---

<sup>8</sup> Kreu VI, Pika 3/d e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.